ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
QEVERIA / VLADA
Nr. Prot. 194/17
Data / Datum 22.06.17
PRISHTINË - PRIŠTINA

Një ankesë kundër:MINISTRIA E SHENDETESISE

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:**206-17-005-111**

Sa i përket tenderit për;" Furnizim me barna nga L.E "

Per Lot:6 –Bacitracin + Neomycin sulphate plv (250IU-330IU) 1 g Jashtem

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

N.T.P. "ICN&BM"

Rr."Ndue Perlleshi "pa nr

Prishtine *10000*

+ *(Numri i Faks-it)*

I Autorizuar: Bejtush Gashi

22.06.2017

ICN&BM Pharmaceutical Wholesalers Office Prishtinë - Kosovë

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

- Neni 7 i Ligjit për prokurim publik në Kosovë Ligji 04/ L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04L/237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.
- Neni 8 i Ligjit për prokurim publik në Kosovë Ligji **04/ L-042** , i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04L/237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.
- Neni 2 i rregullores për prokurim publik "Kalkulimi i vlerës së parashikuar të kontratës publike"
- Neni 16 i Ligjit për prokurim publik në Kosovë Ligji **04/ L-042**, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04L/237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.
- Neni 62 i Ligjit për prokurim publik në Kosovë Ligji **04/ L-042**, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04L/237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.
- Neni 18 Ndërprerja dhe anulimi i procedurës së prokurimit, i rregullores për prokurim publik.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Sipas proces verbalit te hapjes, shihet qarte se ne kemi qene firma qe ka ofertuar me çmim me te ulte për ketë LOT. Kriter për dhënien e kontratës ka qene çmimi me i ulte.
Sipas dosjes se tenderit ne ju kemi përmbajtur çmimit te parashikuar nga ana e autoritetit kontraktues:
Çmimi total i parashikuar nga AK për LOT 6 është -79,800.00euro, kurse oferta jonë për LOT 6 është 69,920€, që do të thotë se oferta jonë është me çmim më të lirë për rreth 15% se çmimi i parashikuar i AK.
Prandaj nuk qëndron arsyetimi i AK për anulim te dhënies se kontratës. Për më tepër kompania jonë *N.T.P."ICN&BM"* ka realizuar një kontratë identike për te njëjtin artikull me po të njëjtin çmim te lidhur po me këtë A.K. Ministria e Shëndetësisë.
Po ashtu, duke marrë për bazë faktin se komisioni i vlerësimit ka vlerësuar se oferta jonë është oferta më e lire e përgjegjshme, si dhe faktin se publikim i njoftimit për dhënien e kontratës është bërë po nga ky AK dhe zyrtari i prokurimit me datë: *18.05.2017*, konsideroj se njoftimi për anulim të dhënies datë: 12.06.2017 është diskriminues i pa arsyeshëm, i pa bazuar në asnjë dispozitë ligjore dhe në kundërshtim me parimet baze të Ligjit për prokurim në Kosovë.
Në veçanti është vepruar në kundërshtim me nenin 7 i Ligjit të prokurimit i cili ju obligon te trajtoj njëjtë të gjithë operatorët ekonomik dhe te mos diskriminoni ata.